



Komuna e Deçanit



NË MES TË KOMUNËS SË DEÇANIT

më tutje "KOMUNA"

DHE

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "HIGJIËNA" SH.A-DEÇAN

më tutje "Higjiëna"

(tutje të referuar si "Palët Kontraktese")

		QALËJE - DEÇAN - QUTISAN REPUBLIKË E KOSOVËS - REPUBLIKË E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. i regjistruar Op. i regjistruar Drejtori	<i>Higjiëna</i>	Nr. i regjistruar Op. i regjistruar Drejtori	6544
Nr. i regjistruar Et. i regjistruar No. i papritur	02	Nr. i regjistruar Op. i regjistruar Drejtori	02.0323
DEÇAN - DEÇANIS			

#### 1. Palët kontraktuese:

Komuna e Deçanit, të cilën e përfaqëson z.Bashkim Ramosaj, Kryetari i Komunës së Deçanit (në tekstin e mëtutjeshëm Komuna)

Ndërmarrja Publike Lokale "HIGJIENA" SH.A-Deçan, të cilën e përfaqëson z.Kushtrim Loshaj, Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtutjeshëm "Higjiena")

#### 2. Hyrje

Kjo (KSH) lidhet midis Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" Sh.A-Deçan dhe Komunës së Deçanit, për kryerjen e shërbimeve në mirëmbajtjen e Qendres Sportive, Qendres Rinore, Kolonise së Artistëve dhe Villave Turstike të Komunës së Deçanit.

Kjo Kontratë për shërbime (KSH) i përmban elementet standarde dhe të detyrueshme për t'u konsideruar e vlefshme.

##### 2.1 Kohëzgjatja

1. Komuna kontraktton N.P.L "Higjiena", Sh.A-Deçan, për t'i kryer të gjitha shërbimet në përputhje me këtë Kontratë.

2. Kjo (KSH) vlen për periudhën nga data: 01/03/2023 deri me datën 31/03/2026.

Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, N.P.L "HIGJIENA" do të kryejë shërbimet si në vijim:

- Palestra Sportive -

- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit.
- Pastrimi dhe Larja e Fushave të jashtme të: Basketbollit dhe Futbollit;
- Pastrimi i parkingut- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i rrugës kryesore- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i rrugës shiritit vrapues - fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Qendrës Sportive ;
- Pastrimi i ulseve të tifozëve.

- Qendra Rinore

- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit neper hapsirat e Qendres Rinore:
- Pastrimi dhe Larja e fushes sportive dhe ulseve te amfiteatrit ne hapsirat e jashtme
- Pastrimi i parkingut- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i rrugës kryesore- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Qendrës Sportive ;

- Kolonia e Artistëve

- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit përreth objektit.
- Pastrimi i parkingut- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i rrugës kryesore- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Objektit të Kolonis së Artistëve ;

- Villat Tursitike

- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit përreth villave
- Pastrimi dhe Larja e villave dhe mirëmbajtja e drurit me lyrje
- Pastrimi i parkingut- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i rrugës kryesore- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Villave

1. Siç është përkufizuar në shtojcën A.B.C.D

### 2.3 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Kontrate është që:

1. Të përkufizohen shërbimet që "HIGJIENA", ia ofron Komunës dhe standardet e kërkuara për mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve.
2. "HIGJIENA" dhe Komuna t'i kryejnë obligimet të specifikuar në këtë kontratë.
3. Të përshkruhen kërkesat për menaxhimin cilësor të shërbimeve duke përfshirë specifikacionet e shërbimit, monitorimit e performancës dhe raportimit.

### 4. Fushëveprimi i shërbimit

#### 4.1 Kushtet themelore

Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, N.P.L "HIGJIENA" do të kryej shërbimet si në vijim:

- Palestra Sportive
- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit.
- Pastrimi dhe Larja e Fushave të Basketbollit dhe Futbollit;
- Pastrimi i parkingut- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i rrugës kryesore- fshirja dhe larja, largimi i borës;;
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Qendrës Sportive ;
- Pastrimi i ulseve të tifozëve.
  
- Qendra Rinore
- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit neper hapsirat e Qendres Rinore:
- Pastrimi dhe Larja e fushes sportive dhe ulseve te amfiteatrit ne hapsirat e jashtme
- Pastrimi i rrugës kryesore- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Qendrës Sportive ;

- **Kolonia e Artistëve**

- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit përreth objektit.
- Pastrimi i parkingut- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i rrugës kryesore- fshirja dhe larja, largimi i borës;
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Objektivit të Kolonis së Artistëve ;

- **Villat Turistike**

- Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë dhe gjelbrimit përreth villave
- Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të Villave

### 3. Siç është përkufizuar në shtojcën A.B.C.D

1. N.P.L "HIGJIENA" e siguron tërë personelin fizik, administrativ dhe pajisjet e nevojshme për ta ofruar një shërbim të kënaqshëm, në mënyrë të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në shtojcën A.B.C.D të kësaj KSH-je.

### 4.2 Shërbimet që do të ofrohen

Shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj Kontrate (sipas standardeve të detajuara të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A.B.C.D mund të përmbledhen si shërbim për mirëmbajtjen e Qendrës Sportive të Komunës së Deçanit, Qendrës Rinore, Kolonisë së Artistëve dhe Villave Turistike

### 5. Forca madhore

Nga "HIGJIENA" nuk do të kërkohej që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar me lartë nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë forcë madhore:

a) Për qëllim të kësaj kontrate është paraparë që punëtorët e paraparë me rastin e kësaj kontrate do të kalojnë në menaxhim të "HIGJIENA" dhe paga mujore për këta punëtor do të paguhet nga "HIGJIENA" vetëm pasi të paguhet fatura mujore nga ana e komunës për këtë kontratë, këta punëtorë do të rekrutohen me konkurs publik nga ana e Kompanisë "Higjiena" për periudhën, sa është kontrata në fuqi, dhe këta punëtorë nuk gëzojnë asnjë të drejtë apo beneficion tjetër nga "HIGJIENA", përveç obligimeve nga paga që buron nga kjo Marrëveshje.

5. Para datës së fillimit të kësaj Kontrate, "HIGJIENA", ua ofron përfaqësuesve të Komunës një listë të detajuar në të cilën përshkruhen pajisjet (përkatësisht automjetet, kamionët dhe pajisjet tjera), dhe burimet njerëzore që do të përdoren për t'i kryer shërbimet. Lista përfshin prodhuesin e automjetit, madhësinë e motorit, numrin e regjistrimit/identifikimit dhe datën e prodhimit të çdo pajisjeje që do të përdoret. Çdo pajisje përfshihet në PIO/Planin Operativ.

## 8. Monitorimi dhe raportimi

Për monitorimin e kësaj Marrëveshje, Drejtori i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport do të caktoj me një vendim të veçantë një ekip tre anëtarësh i cili do të monitoroj të gjitha veprimtaritë e kryera nga ana e NPL "HIGJIENA" si dhe do të aprovoj pagesat të cilat do të bëhen për shërbimet e kryera.

## 9. Faturimi dhe pagesa

9.1 N.P.L "HIGJIENA" për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj Marrëveshje përmes faturës ja faturon Komunës tarifën në fund të muajit për muajin paraprak me tarifën e paraparë në ankesin A.B.C.D të kësaj Marrëveshje.

Këto mjete do të transferohen në xhironlogarinë bankare zyrtare të Kompanisë "Higjiena", me nr të xhironlogarisë bankare: 1506030001729045, Raiffeisen Bank.

9.2 Në rastë se gjatë kohës së zbatimit të kësaj marrëveshjeje, Komuna me ndonjë vendim bënë ndryshimin e tarifave, me këtë vendim duhet të pajtohet edhe nënshkruesi i kësaj marrëveshjeje N.P.L "HIGJIENA" dhe i njëjti është i obliguar që të zbatoj këto ndryshime të tarifave.

## 10. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj KSH-je zgjidhen, në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta. Çdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë: "KSH" dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht duhet të shkallëzohet si vijon:

a. Niveli i parë: Nëse çështja mbetet e pazgjidhur, ankesat duhet t'i parashtrihen me shkrim Bordit të Drejtorëve "HIGJIENA"-së përkatëse, anëtarët e të cilit do ta shqyrtojnë çështjen brenda 5 ditëve të punës. Nëse çështja është e ndërlikuar dhe nuk është e mundur që të zgjidhet plotësisht brenda këtij afati kohor, atëherë një përgjigje e përkohshme me shkrim do të jepet brenda 5 ditëve të punës dhe çështja do të zgjidhet përfundimisht brenda 10 ditëve të punës.

b. Niveli i dytë: Pas nivelit të parë të zgjidhjes së kontestit, nëse çështja nuk është zgjidhur ende, atëherë ankesat, së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet t'i përcillen me shkrim Komisionit Komunal të Aksionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.

c. Niveli i tretë: Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis N.P.L "HIGJIENA" dhe Komunës, duhet të merret në konsideratë arbitrazhi i jashtëm (Gjykata Themelore e Pejës), ndërsa për çdo shpenzim përkatës do të vendosë Gjykata.

2. Deri sa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, N.P.L."HIGJIENA", do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj Kontratë.

#### 11.Ndëshkimet në rast të mospërmushjes së kontratës

Gjatë cilës do fazë të zgjidhjes së pakënaqësisë apo kontestit, shërbimet që ende nuk janë ofruar në shkallën e dakorduar të standardit të përcaktuar në kuadër të këtij dokumenti mund të jenë shkas për një ndëshkim financiar që duhet të përcaktohet pas procesit të monitorimit nga Komuna. Për më tepër, çdo shpenzim që është bërë për ta korrigjuar qdo lëshim apo moszbatim të kësaj "KSH"-je, do të kompensohet në tërësi. Deri sa të merret vendim e te qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, N.P.L."HIGJIENA", do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj Kontratë.

#### 12.Rishikimi i Kontratës

1.Kjo Kontratë dhe të gjitha pjesët përbërëse të saj do të rishikohen sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës së Deçanit.

2.Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit së kësaj Kontratë duhet të dakordohet nga të dyja palët.

#### 13.Anulimi

1.Kjo Kontratë mund të anulohet me pajtimin e të dy palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim për anulimin e kontratës për anulim gjatë periudhës para 4 muajve.

2. Nëse N.P.L "HIGJIENA" nuk i ofron shërbimet e dakorduara në përputhje me standardet e shërbimit që janë përcaktuar në këtë Kontratë gjatë një periudhë të vazhdueshme prej 3 muajve, kjo Kontratë do të anulohet automatikisht dhe Komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguajë asnjë faturë të dorëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe.

## 14.Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e kontratës

Kjo Kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve kontraktuese. Dhe do të zgjasë për një periudhë kohore prej **36 muaj kalendarik**.

## 15.Nënshkrimi i Kontratës

Kjo Kontratë do të nënshkruhet në katër (4) kopje identike, nga dy (2) kopje për secilën palë në këtë marrëveshje.

## 16.Shtojca

Pjese përberëse e kësaj kontratë është shtojca A,B,C.D

Data: 01.03.2023

Kryetar i Komunës së Deçanit

z.Bashkim Ramosaj

  


Kryeshef Ekzekutiv i N.P.L "Higjiëna" Sh.a

z.Kushtrim Loshaj



**Shtojca A-Standardet e detajuara të shërbimit  
Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe hapsirave të  
mbrendshmedhe te jashtme në Palestren Sportive dhe Stadionin e  
qytetit ne -Deçan**

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Cmimi/ Euro		Sqarimet shites
1.	Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë.	m <sup>2</sup>	18.678	0.10	1,867.8	
2.	Pastrimi dhe larja e fushave Basketbollit dhe Futbollit.	m <sup>2</sup>	5,800	0.30	1,740.00	
3.	Pastrimi i parkingut-fshirja dhe larja, largimi i bores.	m <sup>2</sup>	1,705	0.30	511.5	
4.	Pastrimi i rruges kryesore fshirja dhe larja, largimi i bores.	Meter	250	0.30	75.00	
5.	Pastrimi i ulseve te tifozeve	m <sup>2</sup>	3.000	0.30	900.00	
6.	Pastrimi i hapsirave te mbrendshme te qendres sportive.	m <sup>2</sup>	26.888	0.10	2,688.8	
<b>TOTALI=</b>					<b>7,782.6 Euro</b>	

**Shtojca B-Standardet e detajuara të shërbimit  
Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe hapësirave të  
mbrendshmedhe te jashtme në Qendrën Rinore në Deçan.**

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Cmimi/ Euro		Sqarimet shtes
1.	Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë në hapësirat e Qendrës Rinore të Deçanit	m <sup>2</sup>	10,000	0.10	1,000.00	
2.	Pastrimi dhe larja e fushes sportive dhe ulseve të amfiteatrit në hapësirat e jashtme.	m <sup>2</sup>	2,000	0.10	200	
3.	Pastrimi i rruges kryesore fshirja dhe larja, largimi i bores.	Meter	300	0.30	90	
4.	Pastrimi i hapësirave të mbrendshme te qendres rinore	m <sup>2</sup>	2,000	0.10	200	
<b>TOTALI= 1,490.00 Euro</b>						

**Shtojca C-Standardet e detajuara të shërbimit**  
**Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe hapësirave të**  
**mbrendshmedhe të jashtme në Koloninë e Artistëve**

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Cmimi/ Euro		Sqarimet shtes
1.	Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë në hapsirat e Kolonisë së Artistëve	m <sup>2</sup>	5,000	0.10	500	
2.	Pastrimi i parkingut-fshirja dhe larja, largimi i bores.	m <sup>2</sup>	2,800	0.10	280	
3.	Pastrimi i rruges kryesore fshirja dhe larja, largimi i bores.	Meter	700	0.30	210	
4.	Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të qendres rinore të Objektivit të Kolonisë së Artistëve	m <sup>2</sup>	2,000	0.10	200	
<b>TOTALI=1,190.00Euro</b>						

**Shtojca D-Standardet e detajuara të shërbimit  
Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe hapësirave të  
mbrendshmedhe te jashtme në Villat Turistike**

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Cmimi/ Euro		Sqarimet shtes
1.	Pastrimi, kositja e barit bartja dhe deponimi i tij në vendet e duhura, krasitja e shkurreve dhe murit të gjallë në hapësirat e Villave Turistike	m <sup>2</sup>	6,000	0.10	600	
2.	Pastrimi i hapësirave të mbrendshme të villave turistike.	m <sup>2</sup>	3500	0.30	1,050.00	
<b>TOTALI=1,650.00Euro</b>						

Vlera totale e kontrates ;12,11.6 Euro

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Paragrafi 4 i nenit 9 të këtij ligji sa i përket çështjes se si duhet të vepohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik përcakton si në vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik"

Bazuar në nenin e cituar si më lartë, Autoriteti Kontraktues (Komuna e Decanitt), ka

nevojë për sigurimin e shërbimeve, operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik

(në rastin konkret Ndërmarrja Publike regjionale NPL "Higjiena" SH.A.)